



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## PROJEKTLIGJ

Nr. \_\_\_\_/2026

PËR

### DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 15/2019 “PËR NXITJEN E PUNËSIMIT”, I NDRYSHUAR<sup>1</sup>

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në Ligjin nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

#### Neni 1

Në nenin 3 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

- a. Në pikën 4, shkronja h), fjala “... nën...” zëvendësohet me fjalët “...deri në...”.
- b. Në pikën 4, pas shkronjës k) shtohet shkronja l) me përmbajtjen e mëposhtme:  
“l) *nxënës punëmarrës*”
- c. Në pikën 13, pas togfjalëshit “me vendbanim në Republikën e Shqipërisë” shtohen fjalët “ose jashtë saj, kur kërkon të përfitojë nga shërbimet dhe programet sipas këtij ligji”.

<sup>1</sup> Ky ligj është përafruar pjesërisht me Rregulloren (BE) 2016/589 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13 prill 2016, mbi një rrjet evropian të shërbimeve të punësimit (EURES), aksesin e punëtorëve në shërbimet e lëvizshmërisë dhe integrimin e mëtejshëm të tregjeve të punës, dhe që ndryshon Rregulloret (BE) nr. 492/2011 dhe (BE) nr. 1296/2013

- d. Në pikën 14, pas fjalëve "ose i vetëpunësuar" shtohen fjalët "që nuk ndjek arsimin me kohë të plotë dhe nuk ka mbushur moshën për përfitimin e pensionit të pleqërisë, sipas legjislacionit në fuqi".
- e. Pika 17 ndryshohet si vijon:  
*"Punësim i përshtatshëm" është oferta e punësimit që përputhet, në mënyrë të arsyeshme, me kualifikimet, përvojën e mëparshme të punës, gjendjen shëndetësore, vendbanimin, mundësinë e lëvizshmërisë dhe, kur është rasti, me detyrimet familjare ose të kujdestarisë së personit."*
- f. Shtohet pika 22 me përmbajtjen e mëposhtme:  
*"Subjekte të tregut të punës" janë personat juridikë publikë ose privatë, organizatat jofitimprurëse, organizatat ndërkombëtare, institucionet arsimore e formuese dhe subjekte të tjera që, sipas këtij ligji ose akteve nënligjore në zbatim të tij, bashkëpunojnë në ofrimin ose zbatimin e shërbimeve dhe programeve të tregut të punës."*
- g. Shtohet pika 23 me përmbajtjen e mëposhtme:  
*"Nxënës punëmarrës" është nxënësi i regjistruar në një program të arsimit dhe formimit profesional në formën e dyfishtë, i cili, në përputhje me Kodin e Punës, lidh kontratë të mësimi të profesionit me subjektin pritës/trajnuës."*
- h. Shtohet pika 24, me përmbajtjen e mëposhtme:  
*"Observatori i Informacionit të Tregut të Punës dhe Aftësive" është mekanizëm kombëtar digjital dhe i integruar për mbledhjen, përpunimin, analizimin dhe shpërndarjen e të dhënave mbi tregun e punës dhe aftësitë."*
- i. Shtohet pika 25 me përmbajtjen e mëposhtme:  
*"Rrjeti Evropian i Shërbimeve të Punësimit (EURES) është një rrjet bashkëpunimi ndërmjet Komisionit Evropian, shërbimeve publike të punësimit të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, vendeve pjesëmarrëse dhe partnerëve të tjerë të përfshirë, me qëllim lehtësimin e lëvizshmërisë së punëtorëve brenda hapësirës evropiane të punësimit, shkëmbimin e informacionit mbi vendet e lira të punës dhe kërkesat për punë, si dhe ofrimin e shërbimeve të mbështetjes për punëkërkuesit dhe punëdhënësit."*
- j. Shtohet pika 26 me përmbajtjen e mëposhtme:  
*"Sistemi i Pranimi të Anëtarëve dhe Partnerëve EURES" është mekanizmi kombëtar përmes të cilit Zyra Kombëtare Koordinuese e EURES-it pranon, mbikëqyr, pezullon ose heq nga rrjeti kombëtar institucionet që ofrojnë shërbimet EURES."*
- k. Shtohet pika 27 me përmbajtjen e mëposhtme:  
*"Kanali i Vetëm i Koordinuar" është mekanizmi elektronik i transmetimit të ofertave të punës dhe të aplikimeve për punë midis Anëtarëve dhe Partnerëve EURES të vendeve pjesëmarrëse."*

## Neni 2

Në nenin 4 bëhen bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

- a) Pika 2 ndryshon si më poshtë:

*"2. Të drejtën e përfitimit të shërbimeve që ofrohen në strukturën rajonale/vendore e kanë të gjithë shtetasit e huaj dhe ata pa shtetësi, të cilët hyjnë e qëndrojnë, ose synojnë të hyjnë e qëndrojnë në mënyrë të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, për qëllime punësimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të huajt."*

- b) Në pikën 4 togfjalëshi "leje pune" zëvendësohet me togfjalëshin "leje unike".
- c) Shtohet pika 5 me përmbajtjen e mëposhtme:  
*"5. Punëdhënësit subjektet e tregut të punës që zbatojnë programe aktive të tregut të punës, në përputhje me këtë ligj, konsiderohen përfitues të masave mbështetëse të parashikuara prej tij."*

### Neni 3

Në nenin 7 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

- a) Pika 1, shkronja b) riformulohet si më poshtë:  
*"b) Shërbimet e ndërmjetësimit të punësimit për punëkërkuar dhe punëdhënësit përmes përputhjes së ofertës dhe kërkesës për punë."*
- b) Pika 2 riformulohet si më poshtë:  
*"Shërbimet e punësimit për punëkërkuar dhe punëdhënësit, sipas pikës 1 të këtij neni ofrohen pa pagesë nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë. Për shërbime të specializuara që u ofrohen punëdhënëseve, institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, vendos tarifa shërbimi. Shërbimet e specializuara, kriteret, procedurat dhe tarifat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave."*
- c) Në Pikën 3 shtohet fjalia si më poshtë:  
*"Për ofrimin e shërbimeve të punësimit për grupe të veçanta ose në territore të caktuara, institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë kontraktin subjekte të tregut të punës, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave."*
- d) Në pikën 5 pas fjalëve "...sipas pikës 1", shtohen fjalët ", pikës 2 dhe pikës 3".

### Neni 4

Pas nenit 7 shtohet neni 7/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

#### Neni 7/1

*Regjistrimi dhe çregjistrimi i punëkërkuarve/ punëkërkuarve të papunë*

1. Regjistrimi, verifikimi, pezullimi, çregjistrimi dhe rifitimi i statusit të punëkërkuar dhe të punëkërkuar të papunë bëhen nga struktura përgjegjëse e punësimit.
2. Punëkërkuar i regjistruar ka detyrimin të bashkëpunojë me strukturën përgjegjëse të punësimit, të japë informacion të saktë, të njoftojë ndryshimet e rrethanave që ndikojnë në statusin e tij dhe të marrë pjesë në masat e dakordësuara të aktivizimit.
3. Refuzimi i pajustificuar i ofertës së përshtatshme të punësimit, i pjesëmarrjes në masa aktivizimi ose deklarimi i rremë, shkakton pezullimin ose heqjen e statusit.
4. Rregullat, kriteret dhe procedurat për regjistrimin, verifikimin, çregjistrimin, pezullimin, heqjen dhe rifitimin e statusit të punëkërkuar/punëkërkuar të papunë, përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

### Neni 5

Në nenin 11, bëhen bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

- a) Në pikën 2, pas togfjalëshit *“punëkërkuessve të papunë”* shtohen fjalët *“, si dhe personave të punësuar që rrezikojnë humbjen e vendit të punës...”*
- b) Në pikën 2, pas shkronjës l) shtohen shkronjat m) dhe n) me përmbajtjen e mëposhtme:  
*“m) shpenzime të lidhura drejtpërdrejt me zbatimin e programeve nga subjektet e tregut të punës”*  
*“n) shpenzime të tjera të lidhura me zhvendosjen ose riatdhesimin e migrantëve të kthyer”*
- c) Pika 3 ndryshohet sipas përmbajtjes së mëposhtme:  
*Programet e nxitjes së punësimit zbatohen dhe administrohen nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, i cili, kur është e nevojshme, kontraktton subjekte të tregut të punës për zbatimin e tyre.*

## Neni 6

Në nenin 11/1, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

- a) Në nenin 11/1, në pikën 1, togfjalëshi *“... e programeve të punësimit...”* zëvendësohet me fjalët: *“e sistemit të shërbimeve të punësimit dhe të programeve aktive të tregut të punës”*
- b) Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me përmbajtje si më poshtë:  
*“3/1. “Plani i Zbatimit të Skemës së Garancisë Rinore përcakton fazat, programet dhe kontributin e institucioneve përgjegjëse në fushën e arsimit, punësimit dhe mbrojtjes sociale për të rinjtë, me qëllim heqjen e barrierave dhe krijimin e mundësive për hyrjen e tyre në tregun e punës dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional. Plani koordinohet në nivel kombëtar nga ministria përgjegjëse për punësimin dhe aftësitë, ndërsa zbatimi i tij bashkërendohet nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë”.*
- c) Pika 4 ndryshohet si më poshtë:  
*“Plani i Zbatimit të Skemës së Garancisë Rinore dhe procedurat e zbatimit të tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.*

## Neni 7

Pas nenit 11/1 shtohet neni 11/2 me përmbajtjen e mëposhtme:

### Neni 11/2

#### *Mekanizmi i Partneriteteve Vendore*

1. Në fushën e arsimit, punësimit, formimit, mbrojtjes sociale dhe partneritetit social ngrihen mekanizma të partneriteteve vendore, të cilët kanë qëllim kontaktimin dhe aktivizimin e të rinjve që u përkasin grupeve të veçanta, sipas nenit 3, pika 4, shkronja “h”, të këtij ligji.
2. Partneritetet vendore zbatojnë programe dhe veprimtari që synojnë aktivizimin e hershëm të të rinjve, sipas pikës 1 të këtij neni, dhe lehtësimin e pjesëmarrjes së tyre në skemën e

*Garancisë Rinore.*

3. *Llojet e programeve dhe veprimtarive, mënyrat e financimit, si dhe rregullat dhe procedurat për organizimin dhe zbatimin e mekanizmit të partneriteteve vendore, përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.*

## **Neni 8**

Në nenin 14, shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

- a) Në pikën 2, në shkronjën b), pas fjalëve “në bashkëpunim me punëdhënësit” shtohen fjalët “dhe/ose subjektet e tregut të punës”.

## **Neni 9**

Pas nenit 14, shtohet neni 14/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

### **Neni 14/1**

#### **Zyra Kombëtare Koordinuese e EURES-it**

1. *Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë vepron si Zyra Kombëtare Koordinuese e EURES-it në Republikën e Shqipërisë.*
2. *Zyra Kombëtare Koordinuese e EURES-it ushtron këto kompetenca kryesore:*
  - a) *bashkërendon pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në rrjetin EURES dhe siguron funksionimin e rrjetit kombëtar;*
  - b) *administron Sistemin Kombëtar të Pranimit, nëpërmjet të cilit pranohen, mbikëqyren, pezullohen ose hiqen nga rrjeti kombëtar institucionet që ofrojnë shërbime EURES;*
  - c) *transmeton, nëpërmjet Kanalit të Vetëm të Koordinuar të Komisionit Evropian, vendet e lira të paguara të punës që janë publikisht të disponueshme përmes rrjetit kombëtar EURES, si dhe, me pëlqimin e shprehur me shkrim të kërkuarit të punës, aplikimet për punë dhe profilet e kërkuarëve, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale;*
  - ç) *mbikëqyr përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i zbatueshëm dhe garanton bashkëpunimin me Komisionin Evropian dhe partnerët përkatës;*
  - d) *i kushton vëmendje të veçantë ofrimit të shërbimeve specifike për punëtorët ndërkufitarë, në bashkëpunim me strukturat homologe të shteteve fqinje ose të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, përfshirë nëpërmjet partneriteteve ndërkufitare EURES.*
3. *Kriteret minimale për pranimin në Sistemin Kombëtar të Pranimit përfshijnë kapacitetin*

*për të ofruar shërbimet bazë EURES, strukturën organizative dhe burimet njerëzore të përshtatshme, qëndrueshmërinë financiare, si dhe pajtueshmërinë me legjislacionin e zbatueshëm për mbrojtjen e të dhënave personale.*

4. *Organizimi, funksionimi dhe kompetencat e rrjetit kombëtar EURES dhe të Zyrës Kombëtare Koordinuese, kriteret dhe procedurat për pranimin, mbikëqyrjen, pezullimin dhe heqjen e statusit të Anëtarëve dhe Partnerëve të EURES-it, si dhe specifikimet teknike të ndërveprimit me portalin EURES të Komisionit Evropian, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*

#### **Neni 10**

Në nenin 15, pika 5, pas shkronjës "c)" shtohet shkronja "ç)" me përmbajtjen e mëposhtme:  
*"ç) këshillon institucionin përgjegjës për punësimin dhe aftësitë mbi zbatimin e Sistemit të Pranimin të Anëtarëve dhe Partnerëve EURES, sipas nenit 14/1 pika 2, shkronja b) të këtij ligji, si dhe mbi çështje të tjera që lidhen me funksionimin e Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Punësimit (EURES) në Republikën e Shqipërisë."*

#### **Neni 11**

Në nenin 16, pas pikës 2, shtohen pikat 2/1 dhe 2/2 me përmbajtjen e mëposhtme:

*"2/1. Subjektet e tregut të punës, që disponojnë të dhëna për tregun e punës dhe aftësitë, kanë detyrim të shkëmbejnë informacion elektronik në bazën e të dhënave të integruara nëpërmjet Observatorit të Tregut të Punës dhe Aftësive, i cili administrohet nga institucioni përgjegjës për punësim dhe aftësi, në përputhje me legjislacionin në fuqi."*

*"2/2. Të dhënat parësore dhe dytësore, institucionet dhënëse të informacionit, ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave dhe niveli i aksesimit për subjektet e interesuara për informacion nga Observatori i Tregut të Punës, në përputhje me legjislacionin për bazat e të dhënave shtetërore, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave".*

#### **Neni 12**

Pas nenit 16, shtohet neni 16/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

##### *Neni 16/1*

##### *Pasaporta digjitale e punësimit dhe aftësive*

1. *Pasaporta digjitale e punësimit dhe aftësive është dokument elektronik zyrtar, në të cilin pasqyrohen të dhënat kryesore për marrëdhëniet e punës, periudhat e punësimit, profesionin, kualifikimet dhe përvojën e punës së individit.*
2. *Pasaporta digjitale e punësimit dhe aftësive administrohet nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, nëpërmjet një platforme të integruar me bazat shtetërore të të dhënave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

3. Të dhënat e pasaportës digjitale të punësimit dhe aftësive përdoren për qëllime të ofrimit, administrimit dhe verifikimit të shërbimeve dhe programeve të punësimit dhe aftësive, sipas këtij ligji.
4. Përpunimi, shkëmbimi dhe mbrojtja e të dhënave personale që përmban pasaporta digjitale e punësimit dhe aftësive bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe për shërbimet digjitale.
5. Rregullat për funksionimin, përmbajtjen, ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave, mënyrën e përditësimit dhe aksesimit të pasaportës digjitale të punësimit dhe aftësive përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

### Neni 13

Në nenin 18 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

- a) Pika 2 shfuqizohet.
- b) Në pikën 3 fjalët "... për të përfituar nga programet e nxitjes së punësimit dhe të kualifikimeve që zbaton institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë." riformulohen si më poshtë:  
"për të përfituar nga programet aktive të tregut të punës që zbaton institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë në përputhje me vendet e punës që ato ofrojnë".

### Neni 14

Në nenin 19 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

- a) Në nenin 19 shtohen pikat 2.1, 2.2 dhe 2.3 si më poshtë:
  - 2.1. Çdo punëdhënës ka për detyrë të shpallë ose të njoftojë në institucionin përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, vendet e lira të paguara të punës nëpërmjet deklaramit në strukturat përkatëse rajonale/vendore të punësimit. Në çdo shpallje të vendit të lirë të punës, punëdhënësi duhet të bëjë publike intervalin e pagës për pozicionin e shpallur.
  - 2.2 Çdo punëdhënës ka detyrim të deklarojë dhe të përditësojë të dhënat që lidhen me marrëdhënien e punës së punonjësit, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi.
  - 2.3 Çdo punëdhënës që largon nga puna një punonjës ka për detyrë të deklarojë sipas përcaktimeve ligjore largimin e punonjësve dhe ky informacion përcillet dhe tek zyra përkatëse e punësimit sipas vendbanimit të punonjësit. Informacioni i deklaruar përfshirë arsyen e largimit dhe kontakti i punonjësit, përcillet në mënyrë automatike tek institucioni përgjegjës për punësimin."
- b) Në pikën 3 fjalët "e pikës 2...", zëvendësohen me fjalët "pikave 2, 3 dhe 4...".

### Neni 15

Në nenin 22, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

*“Shkela e parashikimeve të nenit 19 dhe të pikës 2 të nenit 20 të këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe konstatohet e sanksionohet nga administrata tatimore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore dhe aktet nënligjore që rregullojnë mënyrën e deklarimit dhe mbledhjes së këtij kontributi.”*

## **Neni 16**

### **Aktet nënligjore**

1. Në nenin 24 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

- a) Në pikën 2 pas fjalëve “nenit 7”, shtohen fjalët, “pika 2, pika 3 dhe pika 5”
- b) Në pikën 2 pas fjalëve “nenit 11/1, pika 4” shtohen fjalët “nenit 11/2, pika 3”;
- c) Në pikën 2 pas fjalëve “nenit 12, pikat 3 dhe 5” shtohen fjalët “nenit 14/1 pika 4”;
- d) Në pikën 2 pas fjalëve “nenit 15 pika 6” shtohen fjalët “nenit 16, pika 2/1 germa b, nenit 16/1, pika 6, nenit 19, pika 3”.
- e) Në pikën 2 pas fjalëve neni 19, fjalët “pika 3” zëvendësohen me fjalët “pika 6”
- f) Në pikën 3, togfjalëshi “... datës 31.12.2023...” zëvendësohet me togfjalëshin “... gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji”.

## **Neni 17**

### **Shfuqizime**

Në nenin 25 në fund të fjalisë “...ndryshuar” shtohen fjalët “dhe Ligji nr.146/2015 “Për punëkërkuesit, ...”.

## **Neni 18**

### **Dispozita tranzitore**

1. Detyrimi i punëdhënësve për punësimin e grupeve të veçanta sipas nenit 20 të këtij ligji, për periudhën tranzitore deri në anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian, do të fillojë të zbatohet si më poshtë:
  - a) Çdo punëdhënës duhet të punësojë një person që i përket grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji, për 125 punonjësit e parë të ndërmarrjes; dhe
  - b) nga një person shtesë, sipas grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji, për çdo 125 punonjës të tjerë të ndërmarrjes mbi parashikimet e bëra në shkronjën “a” të kësaj pike.
2. Punëdhënësi, i cili nuk punëson numrin e përcaktuar të personave, sipas pikës 1 të këtij neni, derdh një kontribut për llogari të Fondit Social të Punësimit në masën 50% të pagës minimale në shkallë vendi, për çdo muaj për çdo person që u përket grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja “c” të këtij ligji, që ai duhet të kishte punësuar sipas këtij neni.
3. Nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian, do të zbatohen kuotat sipas dispozitave të nenit 20 të këtij ligji.
4. Neni 14/1, pika 1, në pjesën që i referohet ngritjes dhe funksionimit të Zyrës Kombëtare Koordinuese të EURES-it në nivel kombëtar, pika 2, shkronjat “b)” dhe “d)”, si dhe pikat 3

dhe 4, në pjesën që i referohet Sistemit Kombëtar të Pranimit, zbatohen që nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

5. Neni 14/1, pika 1, në pjesën që i referohet pjesëmarrjes së Republikës së Shqipërisë në rrjetin EURES dhe bashkëpunimit me Komisionin Evropian, pika 2, shkronjat "a)" dhe "c)", si dhe pika 4, në pjesën që i referohet specifikimeve teknike të Kanalit të Vetëm të Koordinuar, zbatohen nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ose nga një datë e mëparshme, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në rast se Republika e Shqipërisë autorizohet të marrë pjesë, tërësisht ose pjesërisht, në Rrjetin Evropian të Shërbimeve të Punësimit (EURES) para anëtarësimit, në kuadër të marrëveshjeve përkatëse ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian.
6. Deri në fillimin e zbatimit të dispozitave të përmendura në pikën 5 të këtij neni, institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë kryen veprimtari përgatitore, të cilat përfshijnë ngritjen e kapaciteteve institucionale e teknike, shkëmbimin paraprak informacioni me Zyrën Evropiane të Koordinimit dhe me shtetet anëtare, si dhe lidhjen dhe zbatimin e marrëveshjeve dypalëshe ose memorandumeve të mirëkuptimit me institucione homologe të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian

#### **Neni 19** **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**NIKO PELESHI**